

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË



Konferencë shkencore

25-VJETORI I NDËRHYRJES SË NATO-S
DHE ÇLIRIMIT TË KOSOVËS:
NJË ÇEREC SHEKULL SHTETNDËRTIM,
ARRITJE DHE SFIDA –
QASJE MULTIDISCIPLINARE

PROGRAMI

10 QERSHOR 2024, ORA 9:00
SALLA E AKADEMISË
PRISHTINË

PROGRAMI I KONFERENCËS

9:00 – 10:00 Hapja e Konferencës

Prof. Gjyljeta Mushkolaj, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Fjala e hapjes)

Akad. Mehmet Kraja, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (Fjalë përshëndetëse)

SH. T. Z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës (Fjalë rasti)

Akad. Skënder Gjinushi, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (Fjalë përshëndetëse)

Z. Fatmir Sejdiu, ish-President i Republikës së Kosovës

Z. Alfred Moisiu, ish-President i Republikës së Shqipërisë

10:00 – 11:30 Sesioni i parë

- 1. PASKAL MILO:** ROLI I DIPLOMACISË SHQIPTARE NË KONFERENCËN E RAMBUJES DHE BOMBARDIMET E NATO-S NË KOSOVË
- 2. MUHAMEDIN KULLASHI:** KRISTALIZIMI I VENDIMIT POLITIK PËR PJESËMARRJEN E FRANCËS NË INTERVENIMIN E NATO-S MË 1999
- 3. SONJA BISERKO:** KOSOVA NË MARRËDHËNIET E REJA GJEOSTRATEGJIKE
- 4. MARK BASKIN:** KONTEKSTE HISTORIKE PËR NDËRHYRJEN E NATO-S NË KOSOVË
- 5. ARSIM BAJRAMI:** ARGUMENTET LIGJORE DHE POLITIKE PËR INTERVENIMIN E NATO-S NË KOSOVË

11:30 – 12:00 Pushim

12:00 – 15:30 Sesioni i dytë

- 6. VALENTINA DUKA:** NDËRHYRJA E NATO-S PËR ÇLIRIMIN E KOSOVËS: KUJTIME DHE REFLEKSIONE TË LIDERËVE TË ALEANCËS
- 7. FRASHËR DEMAJ:** ROLI I POLITIKËS PAQËSORE NË DIMENSIONET E NDËRKOMBËTARIZIMIT TË ÇËSHTJES SË KOSOVËS 1990-1997.
- 8. KSENOFON KRISAFI:** ARGUMENTET JURIDIKO-NDËRKOMBËTARE NË MBËSHTETJE TË BOMBARDIMEVE TË FORCAVE TË NATO-S PËR SHPËTIMIN E POPULLIT SHQIPTAR TË KOSOVËS
- 9. HAJREDIN KUÇI:** REAGIMI NDËRKOMBËTAR NDAJ KRIZËS SË KOSOVËS 1991-1999
- 10. IBRAHIM GASHI:** LUFTA ÇLIRIMTARE E KOSOVËS 1998-1999
- 11. GJYLJETA MUSHKOLAJ:** NJË ÇEREC SHEKULL LIRI: RRUGA E PAPËRFUNDUAR DREJT PAQES PËR KOSOVËN DHE SERBINË
- 12. DAVID L. PHILLIPS:** 25 VJETORI I NDËRHYRJES SË NATO-S DHE ÇLIRIMI I KOSOVËS
- 13. BEKIM BALIQI:** TRANSFORMIMI I SOVRANITETIT NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE PAS NDËRHYRJES SË NATO-S: NGA INTERVENIMI HUMANITAR NË PËRGJEGJËSINË PËR TË MBROJTUR
- 14. SALIHE SALIHU:** LEGJITIMITETI I INTERVENIMIT TË NATO-S NË KOSOVË DHE DOKTRINA "CLINTON"

15:30 Përmbyllja e Konferencës

SYNIMI I KONFERENCËS

Ndërsa festojmë përvjetorin historik të çlirimit të Kosovës, me këtë konferencë synojmë të bëjmë një rishikim të mundshëm të së kaluarës dhe të identifikojë sfidat me të cilat përballet Kosova në të ardhmen e saj, teksa vazhdon rrugëtimin e saj drejt një shteti të modern dhe të konsoliduar.

Ky është një rast i veçantë, për të festuar fitoren e NATO-s, aleancës më të madhe dhe më të suksesshme ushtarake dhe të vlerave të përbashkëta të anëtarëve të saj: paqes, demokracisë, lirisë dhe sundimit të ligjit.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s ishte përgjigje ndaj mizorive masive të shkaktuara nga terrori shtetëror i Serbisë së Millosheviqit, për të ndaluar gjakderdhjen e mëtejshme në Ballkan dhe për të ndërprerë gjenocidin ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Forca ushtarake e NATO-s u përdor pas shterimit të të gjitha mundësive për zgjidhje diplomatike. Ishte opsioni i fundit, i domosdoshëm dhe legjitim. Pas ndërhyrjes ushtarake, Këshilli i Sigurimit i OKB-së i autorizoi trupat e NATO-s për të vendosur sigurinë në Kosovë, mision të cilin edhe më tej vazhdon ta kryejë me sukses.

Në këtë përvjetor kujtojmë mijëra njerëz të pafajshëm që u vranë dhe që u zhdukën dhe qindra mijëra të dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre, nga Serbia dhe forcat e saj ushtarake dhe paraushtarake.

Konferenca gjithashtu synon të reflektojë përpjekjet heroike të popullit të Kosovës për rezistencë, çlirim dhe vetëvendosje dhe për të mbajtur gjallë kujtimin e vuajtjes së popullit të Kosovës nga shtypja, shfarosja, spastrimi etnik dhe gjenocidi.

Këshilli organizues: Gjyljeta Mushkolaj, Frashër Demaj, Arsim Bajrami